



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 74, datë 28.04.2021

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMEVE DHE RIEMËRIMEVE TË ANËTARËVE TË
KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “WVP FUND MANAGEMENT
TIRANA” SH.A., SHOQËRI ADMINISTRUESE E SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe të Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimeve dhe riemërimeve të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “WVP Fund Management Tirana” sh.a., shoqëri administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, si më poshtë:**
 - **Z. Rupert Strobl - Kryetar i Këshillit të Administrimit;**
 - **Z. Arton Lena - Drejtor Ekzekutiv, Anëtar i Këshillit të Administrimit;**
 - **Zj. Arjola Shegani - Drejtore, Anëtare Ekzekutive e Këshillit të Administrimit;**
 - **Z. Ardian Kelmendi - Anëtar joekzekutiv i Këshillit të Administrimit;**
 - **Zj. Isida Mansaku - Anëtare joekzekutive e Këshillit të Administrimit.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**